

VENDIM
Nr.562, datë 2.12.1999

**PËR PRANIMIN E KËRKESAVE PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesave për dhënien e statusit të veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, deri më datën 30.9.2000.

2. Të ngrihen e të fillojnë nga puna, në rrethe dhe në Bashkinë e Tiranës, komisionet për dhënien e statusit të veteranit, me këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| - kryetari i degës së mobilizimit ushtarak | - kryetar |
| - një përfaqësues nga sigurimet shoqërore | - anëtar |
| - një përfaqësues nga këshilli i rrethit
(për Tiranën nga këshilli bashkiak) | - anëtar |
| - drejtori (përgjegjësi) i muzeut historik të rrethit | - anëtar |
| - drejtor i arkivit shtetëror të rrethit | - anëtar |
| - një jurist | - anëtar |
| - tre veteranë | - anëtar |

Juristi dhe përfaqësuesi i këshillit të rrethit propozohen nga kryesia e këshillit të rrethit (për Tiranën nga Bashkia), ndërsa veteranët propozohen nga organet drejtuese të organizatave të veteranëve në rreth. Përbërjen emërore të komisionit të rrethit e miraton Ministri i Mbrojtjes.

3. Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i shtohen Institutit të Sigurimeve Shoqërore 50(pesëdhjetë)milion lekë, për përballimin e shpenzimeve financiare për vitin 1999 dhe Ministrisë së Mbrojtjes 2 (dy) milionë lekë, për shpenzime administrative: shpërblimi i komisioneve të rretheve, shpërblimi i Komisionit Qendror, pagesat e stafit teknik, shtypshkrimet, blerje kancelarie e pajisje.

4. Masa e shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhje ose për një ditë pune, për anëtarët e komisioneve të rretheve, për specialistët dhe anëtarët e Komisionit Qendror, e përcaktuar në pikat 14 dhe 14/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve të popullit shqiptar", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 10.1.1996 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 (pika 1/e) dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.277, datë 9.5.1997, pika 2" Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative për statusin e veteranit të luftës për vitin 1998", të indeksohet në masën 81.3 për qind dhe të ndryshohet nga 300 lekë në 540 lekë dhe nga 500 lekë në 900 lekë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

6. Pika 2, 3, 15 dhe shprehja " të komisioneve të rretheve", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.190, datë 3.5.1995 "Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", shfuqizohen.

Gjithashtu lista emërore e komisioneve të rretheve, që i bashkëlidhen vendimit të Këshillit të Ministrave nr.540, datë 9.10.1995 "Për miratimin e Komisionit Qendror dhe të komisioneve të rretheve për statusin e veteranit të luftës", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta